

EDMOND MALAJ

**KANONIKËT MESJETARË TË KAPITULLIT TË KATEDRALES
SË DRISHTIT SIPAS STATUTEVE TË SAJ**

Të shkruash për klerin në Drishtin Mesjetar, është punë që nuk mund të ezaurohet vetëm me disa faqe në formën e një artikulli, por këtu synohet të jepet sadopak një ide e botës së pasur klerikale të Kapitullit të Drishtit mesjetar duke u përqendruar vetëm në Statutet e Kapitullit të Katedrales së Drishtit. Këtu do të mundohemi të japim disa të dhëna mbi organizimin dhe mënyrën e jetesës së kanonikëve në Kapitullin e Katedrales së Drishtit sipas Statuteve të këtij kapitulli, të cilat për mendimin tonë gabimisht jepen me përcaktimin “Statutet e Drishtit”.¹

¹ Pa marrë parasysh shkrimet e shumta nëpër faqet e internetit dhe nëpër gazeta, si shembull mund të përmend këtu konferencën shkencore të zhvilluar më datën 19 dhjetor 2014 nga Shkolla e Lartë universitare Jopublike “Luarasi” me temë të emërtuar gabim si “*Statuti i Drishtit, dokument me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë*”, apo edhe artikullin e Shaban Sinanit: Shaban Sinani, “**Statutet e Drishtit** dhe e drejta urbane në periudhën arbërore”, në: *Perla – Revistë Shkencore – Kulturore tremujore*, Viti X 2005, Nr. 4 (39), f. 27-57. Ai krahas statuteve të tjera flet në fakt për Statutet e Katedrales, por gjithkund jep shkurt përcaktimin e gabuar “Statutet e Drishtit” që shihen edhe në dritën e një të drejte urbane, duke krijuar si sfumatur mbi të drejtën kishtarë, nën dritën e së cilës kryesisht duhej të shiheshin më tepër këto statute. Pastaj në lidhje me të drejtën urbane, jemi të mendimit që, Drishti duhet të ketë pasur edhe Statutet e veta (jo ato të kishës), ngaqë ato përmenden në dokumente të ndryshme si tek: *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 457 (Në vijim cituar si: AAlb. II, nr.) AAlb II, nr. 591; AAlb II, nr. 728; *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Secunda: Saeculi XV Praescanderbeganam Periodum complectentis. Tomus Quintus: Annos MCDVII ad MCDIX illustrans. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del’ Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968. nr. 1392, f. 188, ref. 1. (Në vijim cituar si: AAV V, nr.) AAV III, nr. 1034.

Kisha Katedrale e Ipeshkvisë së Drishtit kishte “statutet e saj”, të përbëra prej 53 kapitujsh, nëpërmjet të cilave rregullohej jeta dhe veprimtaria e klerit aty. Ekzistenca e tyre bëhet e njohur në vitin 1392. Këto statute ishin zakonore dhe të vjetra, këtë e nxjerrim nga teksti i tyre (“*antiquissima et observata consuetudine secundum morem et consuetudinem antiquorum*”²). Dorëshkrimi është i shkruar nga kanoniku dhe noteri i Tivarit Simeon Dromasus më 12 janar 1468³, por editimi i tij qe bërë që në vitin 1456.⁴ Mesa duket në fiksimin përfundimtar të Statuteve ishte marrë edhe arqipeshkvi i Durrësit, Pal Engjëlli, i cili e kishte bërë këtë punë në Manastirin Benediktin të Shën Teodorit *Elohiero* në Durrës.⁵

Statutet e këtij kapitulli janë një dokument me vlerë, pasi pasqyrojnë organizimin e jetës klerikale brenda këtij kapitulli. Ato pra nuk janë “statutet e Drishtit”, siç dëgjojmë të thuhet shpesh herë nëpër media të ndryshme kur bëhet fjalë për Drishtin.

Ato nuk kanë të bëjnë fare me organizimin dhe administrimin e këtij qyteti dhe nuk ka të paktën asnjë kapitull të këtyre statuteve që të na japë ndonjë të dhënë mbi ligjet e qytetit. I gjithë ky korpus ligjesh mbetet brenda kuadrit të kapitullit të katedrales. Përveç faktit që i përkasin Katedrales së Drishtit, lidhja tjetër e vetme me qytetin është fakti që kanonikët të cilët përzgjidheshin me anë të këtyre statuteve duhet të ishin vetëm nga Drishti, nga “*shtëpi të mira drishtjane*” (*bona domo Drivastensi*).⁶

Duhet të thuhet këtu që, Statutet e Kapitullit të Katedrales të Drishtit ishin një formë e së drejtës kishtare e përhapur në të gjithë botën katolike, si shembull mund të përmendet këtu p.sh., nga Gjermania e largët “*Statutet e Kapitullit të Kishës së Regensburgut*” (*Statuta capituli*

² “Statutet dhe urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit”, botuar nën kujdesin e Dr. Viktor Novak dhe Dr. Emilian Shuflaj, në: *Gjurmime Albanologjike. Seria e Shkencave Historike 1-1971*, Prishtinë: 1972, Kap. 46.

³ Etleva Lala, Musa Ahmeti, “Koha dhe rrethanat e krijimit të dorëshkrimit”, në: *Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis)*, Tiranë: OMBRA GVG 2009, Cap. XLV, f. 19. (Cituar si: *Statuta et Ordinationes*, f. ose Capn. Nr.)

⁴ *Po aty*, f. 141.

⁵ Oliver Jens Schmitt, “Paul Angelus, Erzbischof von Durazzo und seine Bedeutung für den Türkenkampf”, në: *ΘΗΣΑΥΡΙΑΣΜΑΤΑ* 30 (2000), f. 148. (Cituar si: O. Schmitt, “Paul Angelus”).

⁶ M. Ahmeti, E. Lala, “Koha dhe rrethanat e krijimit ...”, f. 166.

ecclesiae Ratisponensis) me autor Konradus de Megenberg, të hartuara në vitin 1355;⁷ nga vendet e Zvicrës “*Statutet e Kapitullit të Kishës Katedrale të Bazelit*” (*Statuta Capituli Ecclesiae Cathedralis Basileensis*)⁸, etj.

Statutet thuhet se janë të vjetra dhe këtë e mësojmë nga vetë teksti i tyre, ku shkruhet se ato janë zakone shumë të vjetra që respektohen me kohë, të cilave nuk u dihet zanafilla “*antiquissima et observata consuetudine, cuius initii memoria non existit*”⁹, por që ishin përmirësuar nga kanonikët, sipas nevojave që kishin lindur dhe ishin parashtruar sërish për të konfirmuar.¹⁰

Çfarë ishin kanonikët?

Ngaqë këto statute kishin të bënin me kanonikët e Katedrales së Shën Mërisë së Drishtit, ja vlen të sqarohet këtu se, çfarë ishin kanonikët. Kanonikët (lat. *canonici*) qenë klerikë që i përkisnin një urdhri fetar katolik dhe që jetonin së bashku, sipas një ligji kanonik sipas shembullit të Augustinit të Hippos (*354 - †430) apo të Euzebit të Verçelit (*283 - †371).¹¹ Këto bashkësi nuk përbëheshin vetëm nga meshkuj, por edhe nga femra, të cilat quhen kanonesa.

Më vonë, sidomos duke filluar aty nga shek. X, kanonikët filluan të bashkëjetonin në të ashtuquajturit kapituj katedralesh¹² ose manastiresh

⁷ Conradus de Megenberg, *Statuta capituli ecclesiae Ratisponensis*, http://www.geschichtsquellen.de/repOpus_01283.html (1. 7. 2014)

⁸ *Statuta Capituli Ecclesiae Cathedralis Basileensis*.

URL: <http://www.zvab.com/Ecclesiae-Cathedralis-Basileensis-Prooemium-historicum-authentica/177097683/buch> (1. 7. 2014)

⁹ “*laudabilem consuetudinem antiquorum nostrorum immanentes*” *Statuta, Cap. II, f. 144*; “*antiquissimam consuetudimen immitantes statuimus*”. Po aty, *Cap. XXXIX, f. 162*; *Cap. XXXXIII, f. 164*.

¹⁰ *Statuta et Ordinationes*, f. 139

¹¹ Për të dhënat mbi termin “Kanonik” u jemi referuar burimeve: “Kanoniker, Kanonissen”, në *Ökumenisches Kirchenlexikon*. Online-Version. URL: http://www.heiligenlexikon.de/Glossar/Kanoniker_Kanonissen.htm (28. 6. 2014.); *Wörterbuch des Christentums. 1500 Stichwörter von A bis Z*. Hrsg. v. Volker Drehsen [u. a.] Genehm. Sonderausg. München: Orbis 2001, f. 110-112; *Biographisch-Bibliographisches Kirchenlexikon*. Bd. I. herausgegeben von Friedrich-Wilhelm Bautz. Hamm: Traugott Bautz 1990, spalten 272-300.

¹² Në lidhje me të dhëna të mëtejshme mbi kapitujt e katedraleve në Shqipërinë mesjetare, shih: Milan fon Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke. Zona e depërtimit ortodoks në “digën” katolike*, përktheu nga origjinali gjermanisht dhe

dhe ndanin e përdornin ndërmjet tyre pasuritë që kishin këta kapituj apo manastire. Ata ishin dy llojesh, kanonikë rregulltarë (lat. *canonici regulares*) dhe kanonikë shekullarë (lat. *canonici seculares*). Kanonikët rregulltarë ishin të tillë, kur bënë betimin dhe vijonin të jetonin pastaj sipas një rregulli të caktuar që bazohej kryesisht tek Augustini i Hippos. Si shembull mund të përmenden këtu kanonikët e Drishtit, të cilët pranoheshin me betim në gjirin e kanonikës¹³ dhe jeta e tyre brenda kanonikës rregullohej nga një sërë rregullash që përmbledheshin në *Statutet e Kapitullit të Katedrales së Drishtit*.

Kanonikët shekullarë nuk bënë betim, jetonin në një formë shekullare, i afroheshin pasurive të kishës që të kenë akses në to dhe i përkisnin kryesisht shtresës fisnike¹⁴ dhe shumë prej tyre bëheshin kanonikë, sepse nëpërmjet kësaj ata mund të ngjiteshin deri në rangje të larta të hierarkisë kishtare, gjë që përbënte interes për pushtetin apo bën pozitën e tyre politike, shoqërore dhe ekonomike. Shtimi i tyre çoi më vonë në një shekullarizim të tepërt të Kishës Katolike dhe si rrjedhim u ndërmorën shumë reforma, ku ndër më radikale ishte *rregulla premonstratense* në shek. XII.

Kanonikët e Drishtit

Kanonikët e Drishtit, siç e thashë edhe më sipër, ishin kanonikë rregulltarë, sepse pranoheshin me betim në kapitull dhe i përmbaheshin një sërë rregullash të kodifikuara në *Statutet e Kapitullit të Katedrales së Drishtit*. Mbase këta kanonikë ishin të urdhrit françeskan, porse kjo nuk mund të thuhet me siguri, pasi nëpër dokumente që sot për sot janë në dispozicion, nuk jepet mundësia të sqarohet përkatësia e tyre tek ndonjë urdhër. Por duhet të theksohet që prania e françeskanëve në Drisht është më se e vërtetuar, sepse këtij urdhri i përkisnin edhe disa ipeshkvij të Drishtit.

përgatiti për botim Dr. phil. MA Edmond Malaj, Shkodër: Botime Françeskane 2013, f. 118-122.

¹³ Në lidhje me betimin e kanonikëve shih më konkretisht betimin e kanonikëve të ri të Drishtit në: *Statuta*, Cap. XLVI, f. 170.

¹⁴ Edhe kanonikët e Drishtit siç do ta shohim edhe më poshtë i përkisnin kryesisht shtresës fisnike të qytetit, për këtë shih listën e kanonikëve në fund të këtij artikulli, si dhe: Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*. München: Oldenburg 2001 (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 135. (Në vijim cituar si: O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f.)

Këtu, si shembull, mund të përmendim së pari *Nikolaus Baxie de Vegla* që ishte i urdhrit françeskan minorit (*ex Ordine Fratrum Minorum*) dhe u emërua Ipushkëv i Drishtit më datë 15. 2. 1391 nga Papa Bonifaci IX¹⁵, për shkakun se mendohej se Kisha e Drishtit ishte vakante dhe ai qe ipushkëv i Drishtit deri më datë 16.2.1394.¹⁶ Urdhrit Françeskan i përkiste edhe një ipushkëv tjetër i Drishtit dhe ky quhej *Andreas de Montanea* që u shugurua në vitin 1396, porse ofiqin e tij ai e filloi më 16. 8. 1398 dhe ndenji dy vjet.¹⁷ Edhe kleriku i lartë nga Shkodra, Franciskus de Skutaro (*Franciscus de Scutaro*), i përkiste urdhrit minorit françeskan (OFM),¹⁸ dhe qe po ashtu ipushkëv i Drishtit nga viti 1404 deri në vitin 1424.¹⁹

Më tej, ia vlen të përmendim këtu edhe atin françeskan nga Drishti, Euxhenio Sumën, pjesëtar të familjes së Sumajve. Euxhenio Suma ishte një ndër predikuesit e kryqëzatës të periudhës 1455-1458, të organizuar nga Papa Kaliksti III, kurse në kohën e Papë Nikollës V, atë e emëruan nunc, ndërsa nga Kaliksti III iu dhanë të drejta të shumta.²⁰ Këto të dhëna të lidhura me Urdhrin Françeskan në Drisht, të çojnë në një farë mënyre në konkluzionin që edhe kapitulli i katedrales së Drishtit me kolegjet e tij duhet t'i ketë përkatur këtij urdhri.

Kapitulli i Kishës Katedrale të Drishtit, mesa duket, ishte një faktor i fuqishëm pushteti në qytet. Ai mbulonte funksione administrative brenda Drishtit dhe kishte një ndikim të madh edhe në zgjedhjen e ipushkëvit.²¹

¹⁵ AAlb. II, nr. 457; shih edhe: *Illyrici Sacri*, Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: Arbi 2004), f. 237 (Cituar si: D. Farlati, *Illyrici Sacri*, VII, f.).

¹⁶ AAlb. II, nr. 457, ref. 1.

¹⁷ D. Farlati, *Illyrici Sacri*, VII, f. 237. Për datën e saktë shih edhe: Titular Episcopal See of Drivastum (Albania).

URL: <http://www.gcatholic.org/dioceses/former/t0662.htm> (25. 10. 2013)

¹⁸ AAV V, nr. 1392, f. 188, ref. 1.

¹⁹ "*Patria Scodrensis, religione vitae instituto Franciscanus, cuin Innocentius VII. anno apud Waddingam 1404 Ecclesiam Drivastensem demandavit [...]*". D. Farlati, *Illyrici Sacri* VII, f. 238.

²⁰ G. Valentini, "Shtojcë D. Lista e predikuesve të kryqëzatës", në: Sciambra/ Valentini/ Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe Kryqëzata (1455-1458)*, Tiranë: Plejad, 2009, f. 259-260.

²¹ O. Schmitt, *Das venezianische Albanien*, f. 135.

Ky fakt, pra ndikimi në zgjedhjen e ipeshkvit, na shtyn edhe në supozimin që kanonikët e katedrales duhet t'i kenë përkitur Urdhrit Françeskan.

Kanonikët e Kapitullit mbulonin detyra të ndryshme në lidhje me punët publike të qytetit, si noterë apo taksambledhës. Ata shpesh herë ishin përfaqësues të qytetarëve të tyre dhe dërgoheshin jashtë vendit pikërisht për këtë punë.²² Kanonikët e këtij kapitulli përbëheshin kryesisht nga persona prej familjesh fisnike të qytetit si Ungri, Summa, Prekali, Zaon, Belli, etj.²³

Përzgjedhja e kanonikëve

Përveç kolegjit kanonikal të Katedrales së Shën Mërisë në Drishtë ekzistonte edhe kolegji kanonikal i Shën Gjergjit (*canonisi di San Zorzi*).²⁴ Këta të gjithë mesa duket jetonin në një kanonikë të përbashkët.²⁵ Përzgjedhja e tyre bëhej nga vetë kapitulli dhe nuk kërkoheshin miratimi apo konfirmimi i ipeshkvit.²⁶ Për përzgjedhje të favorizuar ishin së pari, kushërinjtë dhe të afërmit e vetë kanonikëve. Këta shiheshin që në fëmijëri, se si shërbenin në kishë dhe a ishin të mirë e të përshtatshëm për priftërinj e të etur për t'u bërë kanonik.²⁷ Pra, si rrjedhim duhej të ishin nga qyteti i Drishtit dhe nga “shtëpi të mira drishtjane” (*bona domo Drivastensi*). Ky rregull i përzgjedhjes së tyre nga familjet e Drishtit ekzistonte që 40 vjet (nga dalja e këtyre statuteve), pra më përpara del, se ishin pranuar në kanonikë edhe të tjerë jo-drishtjanë.²⁸

Kur pikasej një person i përshtatshëm, i bëhej lutje prokuratorit ose rektorit për të mbledhur kapitullin, “duke u thënë se dëshironin të

²² *Po aty*.

²³ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

²⁴ Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 254. (Cituar si: M. Šufflay, “Kirchenzustände”, në: *Forschungen I*, f.)

²⁵ *Po aty*, f. 265.

²⁶ *Statuta*, Cap. XLIV, f. 165.

²⁷ *Statuta*, Cap. XLV, f. 165.

²⁸ *Po aty*, f. 166.

parashtronin në prani të tyre disa gjëra dhe, pasi bëhej mbledhja, vetë të afërmit, në rast se kishin autoritet, merrnin pjesë ose dërgonin burra me autoritet, për të parashtruar kriteret e mira të atyre meshtarëve, mirësinë e tyre, qëllimin për t'i shërbyer kishës dhe u luteshin të gjithëve që me favor të veçantë t' i zgjidhnin ata dhe t' i bënin kanonikë.”²⁹ Si kanonikë pranoheshin pra, ata persona që i kishin cilësitë morale të larta, ishin të përkushtuar ndaj kishës dhe si kriter tjetër ata duhet të njihnin gramatikën (latine – E.M.), ose të paktën të ishin lexues dhe këngëtarë të mirë.³⁰

Ata persona që ishin pezulluar më parë ose ishin të paafte në njëfarë mënyre, ose ishin të çrregullt apo të pandershëm. Të tillë konsideroheshin: *konkubinarët, kumarxhitë, ata që frekuentonin pijetoret ose ishin pijanecë, idhnakët, të tërbuarit*, ata që bënin *skandale*, ata që ishin të njohur si vjedhës, etj., pra të gjithë këto kategori personash me *moral të cenuar*, nuk lejohej që të përzgjidheshin si kanonikë.³¹ Në rast se dikush prapëseprapë e kalonte zgjedhjen dhe i kishte këto veti negative atëherë, zgjedhja dhe emërimi i tij nuk kishin vlerë. Për këtë çështje thirrej kapitulli me secilin kanonik dhe ky person pushohej së qeni kanonik dhe nuk kishte të drejtë të deklarohet më si i tillë.³²

Përzgjedhja e kanonikut bëhej sipas një rendi, formule dhe një rituali të përcaktuar mirë, për të cilat statutet na japin vetëm disa të dhëna. Kanonikët pjesëmarrës në procesin e pranimit të një anëtari të ri duhet të betoheshin sipas një formule të caktuar për ndershmeri objektivitet dhe paanshmeri në lidhje me votën që do të jepnin. Kjo formulë ka këtë përmbajtje:

“Unë “N”, kanonik drishtjan, nuk do të zgjedh tjetër veç atij që e quaj të urtë dhe të vlefshëm për kishën dhe për kanonikën tonë; gjithashtu atë që e di se është i përshtatshëm dhe plotëson kriteret dhe cilësitë, që përmban statuti ynë dhe që u lexuan, dhe aq sa mund të njohim si njerëz të brishtë. Çdo gjë, që do të flitet dhe që do të bëhet në këtë kapitull do ta mbaj sekret dhe nuk do t'ia tregoj askujt, përveçse në qofshin gjëra që mund t' i sjellin dhe t' i shkaktajnë dëm, turp, paragjykim, urrejtje ose armiqësi dikujt. Dhe nuk do ti tregoj askujt se kush e ka dhënë votën e kush jo, ose kush ka folur mirë për dikë dhe

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Po aty*, f. 166-167.

³¹ *Po aty*, Cap. XLV, f. 166.

³² *Po aty*, Cap. XLV, f. 167.

kush keq. Për këtë më ndihmoftë Zoti dhe këta ungjij të shenjtë të Perëndisë.”³³

Kanonikët duhet të shprehnin lirshëm atë që kishin në ndërgjegje për kandidatin në fjalë dhe të shfaqnin mendimin e vet, nëse kandidati ishte i përshtatshëm apo jo.³⁴ Pasi bëhej votimi dhe shihej, sesa vota ishin pro dhe sa ishin kundër, ata që kishin fituar shumicë të madhe votash ose të gjitha votat, silleshin para të gjithë kanonikës së mbledhur, u shfaqej gatishmëria dhe mirësia e kapitullit ndaj tyre dhe bënin betimin, sipas formulës në vazhdim:

“Unë “N”, i zgjedhur kanonik i kishës së Drishtit, që prej këtij çasti e tutje do të jem besnik ndaj kapitullit dhe i bindur ndaj atyre, që do të më ngarkojnë me detyrat e tij, do të kujdesem për të mirën dhe për dobinë e kishës së lartpërmendur, për kapitullin dhe kanonikët dhe kurrë nuk do të lejoj që të shitet, të dhurohet ose të tjetërsohet në ndonjë mënyrë ndonjë pronë e kapitullit dhe e kanonikës. Do të mbroj, sa të mundem, të drejtat, pronat, regalitë dhe juridiksionet e kapitullit ose të kanonikës së lartpërmendur kundër kujtdo; do të ruaj statutet, si ato të shpallurat ashtu edhe ato që do të shpallen, dhe në rast se do veproj në kundërshtim me sa u tha më lart, për të cilën ndoshta rektori ose kapitulli do të më dënojnë përgjithnjë ose për një kohë të caktuar, unë nuk do të paraqes ankesën time për të kërkuar drejtësi në asnjë vend tjetër as në prani të dikujt tjetër përveç se në kapitullin e lartë përmendur ose para rektorit, edhe pse do të kem përshtypjen se mund të jem dënuar padrejtësisht. Për këtë më ndihmoftë zoti dhe këta Ungjij të Shenjtë të Perandorisë.”³⁵

³³ “*Ego N, Canonicus Drivastensis, non eligam nisi quem novero bonum et utilem ecclesie et canonice nostre; et quem sciam ydoneum et habere eas conditions et qualitates, que in nostro statuto continentur et modo lecte sunt, quantum hmana fragilitas nosce sinit. Tenebo secretum quicquid dictum aut factum erit in presenticapitulo, et in nemini manifestabo, nisi ea fuerunt que neque dampnum, neque verecundiam, neque preiudicium, odium, scandalum vel inimicitiam alicui facient aut generabunt. Neque aliqui manistabo quis dedit vocem, et quis non dedit vocem, et quis non dedit, vel quis beneloquutus est pro aliquot, et quis male. Sic me dues adiuvet, et hec sancta dei evangelia*” Statuta, Cap. XLVI, f. 169-170.

³⁴ *Po aty*, f. 168.

³⁵ “*Ego N, electus Canonicus ecclesie Drivastensis, ab hac hora in antea ero fidelis capitulo et obediens in his, que mihi mandabunt eius offitiales; bonum et utile ecclesie predictae, capitulo, et canonicus procurabo, neque umquam consentiam, ut aliqua possessio capituli et canonice vendatur, donetur vel alienetur aliquot modo. Jura ossesiones, regalia et iurisdictiones capituli seu canonice predictae contra quoscumque*

Pas betimit pranoheshin për “*puthjen e paqes*” dhe që në atë çast konsideroheshin pastaj kanonikë të kapitullit, “të zgjedhur dhe të emëruar sipas zakonisht të të vjetërve”.³⁶ I gjithë procesi shënohej në një regjistër, kurse emri i kanonikut të ri, bashkë me datën dhe vitin kur është bërë, shënohej në një regjistër tjetër, dhe atij i jepej një dokument pranimi, të lëshuar në pallatin kanonikal, që vërtetonte zgjedhjen dhe anëtarësinë e tij në kanonikë.³⁷

Kanonikët duhej të paguanin në fillim edhe dhjetë dukatë flori (*X ducatis auri*) ose një pasuri me të njëjtën vlerë, shumë që do të përdorej për të shtuar pronat dhe orenditë e “shtëpisë së kanonikëve” apo edhe për orendi të tjera zbukurimi e përdorimi.³⁸ Këto shuma që grumbulloheshin përdorreshin edhe për të mbrojtur të drejtat e kapitullit në Kurinë Romane apo ndokund tjetër.³⁹ Dhjetë dukatë ari për t’u derdhur në fillim nga kanonikët e sapoproanuar, kjo shumë ishte mjaft e madhe. Por në statutet pranohet kjo gjë në mënyrë indirekte edhe tregohet edhe shkakun pse duhej të paguhej. Kjo ndodhte për arsyen e gjendjes së rëndë ekonomike që ishte krijuar në atë kohë dhe mungesën apo pamjaftueshmërinë e burimeve të tjera.

Në kapitullin XLVIII (48) madje përmendet se ndodhte, që kanonikët të mos kishin të ardhura as edhe për dy muaj rresht, që të ushqeheshin së bashku në kanonikë dhe si rrjedhojë detyroheshin “*t’i përvisheshin punës së krahut për të përballuar jetesën*”.⁴⁰ Kanonikët e rinj me sa duket, në shumë raste nuk mundnin ta paguanin menjëherë këtë shumë blatimi prej 10 dukatësh, dhe si rrjedhim ata nuk pranoheshin as në mensë, as nuk merrnin pjesë në ndarjen e gjërave të tjera dhe as në kor, përse kohë ata nuk e kishin paguar të gjithë blatimin.⁴¹

pro posse deffendam; statute tam edicta quam edenda servabo, et si quid fecero contra aliquod ipsorum, pro quo vel rector vel capitulum me forsitan condempnerit in perpetuum vel ad tempus, in nullo alio loco, neque coram aliquot alio, quam in capitulo predicto vel rectori querellam faciam pro obtinenda iustitia, etsi mihi visum fuerit esse mihi iniuste condempnatum. Sic me Deus adiuvet, et hec sancta Dei evangelia”. Statuta, Cap. XLVI, f. 170.

³⁶ “*electi et instituti secundum morem et consuetudinem antiquorum*”. Po aty, f. 169.

³⁷ Statuta, Cap. XLVII, f. 171-172.

³⁸ Statuta, Cap. XLVIII, f. 173.

³⁹ Statuta, Cap. XLVI, f. 173.

⁴⁰ “*Quo fit ut plures ex nobis, quibus opulentum patrimonium non est, manuum insistent labori, ut vitam possint sustentare*.” Statuta, Cap. XLVIII, f. 173.

⁴¹ Statuta, Cap. XLIX, f. 173.

Ata kanonikë që ngriheshin në hierarki kishtare, si për shembull ipeshkvij, kryeipeshkvij apo edhe abatë manastresh, dilnin nga kanonikati dhe nuk ishin më pjesë e tij.⁴² Edhe ata kanonikë që ndërronin besimin nuk ishin më pjesë e kanonikatit.

Jeta në bashkësi brenda kapitullit

Kanonikët e kishin zakon të ushqeheshin çdo ditë të gjithë së bashku në kanonikë dhe të jetonin në paqe dhe në qetësi.⁴³ Kanonikët nuk duhej të mungonin në mensë asnjë ditë përveç rasteve, kur ishin larguar me shërbime ndaj kanonikës, kishin shkuar të punonin në trojet e kanonikës apo ishin të sëmurë. Nëse ata mungonin në mensë, pa ndonjë arsye për atë ditë, u jepej vetëm vera, por jo ushqimi.⁴⁴

Nëse dikush mungonte për tetë ditë, sepse ishte larguar jashtë qytetit, atëherë nuk merrte asnjë pjesë nga ushqimi dhe nga vera që shpërndahej në kanonikë, deri sa të kthehej, me përjashtim të rasteve kur personi ishte dërguar me shërbim nga vetë kanonika për punët e saj.⁴⁵

Në mensë nuk lejohej që të sillej nga kanonikët ndonjë vajzë, ngaqë konsiderohej vend meshkujsh klerikë katolikë, që dhe si i tillë, nëse e shprehim me fjalët e statuteve “*nuk është e ndershme që të vijnë vajza në të tillë vend edhe pse mund të jenë mbesa dhe farefis*”.⁴⁶ Mosrespektimi i këtij urdhri dënohej me dëbim për shtatë ditë.

Në kanonikë nuk kishte dhe nuk lejohej të bëhej listë e kanonikëve dhe nuk kishte një numër të caktuar se sa duhet të ishin. Disa nga kanonikët përfitonin prebenda (benifice dhe përfitime kishtare), të cilat nuk kishin (dhe nuk duhet të kishin) dallime të specifikuara, megjithëse statutet nuk na japin informacion rreth llojit të tyre.

Emrat e kanonikëve të vdekur shënoheshin të gjithë në një kalendar me qëllim që të përkujtoheshin për çdo vit dhe kur vdiste një kanonik të thuheshin nga tri meshë nga të gjithë kanonikët brenda tetë ditëve, dhe nëse nuk bëhej kjo atëherë gjoba ishte 4 groshë për çdo meshë.⁴⁷

⁴² Statuta, Cap. XLII, f. 163.

⁴³ Statuta, Cap. XXV, f. 156.

⁴⁴ Statuta, Cap. XL, f. 163.

⁴⁵ Statuta, Cap. XXXIX, f. 162.

⁴⁶ “*Non est enim honestum in tali loco paellas convenire, lectet neptes sint et propinque.*” Statuta, Cap. XXXVIII, f. 162.

⁴⁷ Statuta, Cap. LIII f. 175-176.

Rektori, prokuratori dhe zgjedhja e tyre

Pozicionin kryesor në Kanonikë e kishte rektori. Siç e përmendëm edhe më lart, ai zgjidhej ditën e Shën Barnabës dhe kjo bëhej çdo vit. Ky zakon dukej se ishte i vjetër në këtë kanonikë, pasi bazohej në traditat e hershme.⁴⁸ Zgjedhja bëhej nga një grup kanonikësh që përbëheshin nga tre pleq dhe dy të rinj.⁴⁹ Ata tërhiqeshin në vend të veçantë dhe konsultoheshin me njëri tjetrin në lidhje me kandidaturat e paraqitura. Rektori zgjidhej për një vit. Pasi kanoniku kandidat zgjidhej, ai duhej të bënte betimin dhe më pas njihej zyrtarisht si i tillë. Kur kanoniku i zgjedhur nuk pranonte detyrën atëherë ai rrezikonte të humbiste dobitë e kanonikës për një vit.

Detyra e rektorit ishte shumë komplekse.⁵⁰ Atij i duhej të kujdesej për çdo gjë të dobishme dhe të nevojshme për kanonikën e Drishtit. Po t'i referohemi tekstit të statuteve, rektori kishte si detyrë mbarëvajtjen e financave. Aty rektori duhej të kontrollonte dhe të mbante llogari për të gjitha të ardhurat e kanonikës. Ai organizonte edhe punët brenda në kanonikë, duke ngarkuar apo shkarkuar persona në detyrë, sipas rasteve që paraqiteshin. Atij ia lejonte detyra që të dënonte apo të dëbonte persona nga kanonika, por këto dëbime dhe dënime lejoheshin vetëm për gjëra të pakomplikuara, pasi në rast të kundërt, kur faji ishte i madh, ai duhej të mblidhte kapitullin për të marrë vendim kundër fajtorit. Ai duhet të merrte pjesë në çdo gjyq qoftë kishtar qoftë shekullar, pra mesa shihet, rektori i kapitullit kishte një rëndësi të veçantë edhe në pushtetin gjyqësor të krejt qytetit të Drishtit.

Përsa i përket zgjedhjes së *prokuratorit* të kanonikës, ishte e njëjta procedurë që përmendëm më sipër për rektorin, po në ditën e Shën Barnabës dhe po nga një grup me të njëjtën përbërje (pesë kanonikë, tre të moshuar dy të rinj).⁵¹ Si shembull konkret mund të sjell këtu zgjedhjen në detyrën e prokuratorit më datë 18 qershor 1353 presbiterin *Nikolla i Drishtit*.⁵² Prokuratori kishte si detyrë⁵³ të merrte në dorëzim me shkrim të gjitha objektet që ndodheshin në kanonikë; të kujdesej për kultivimin e

⁴⁸ Statuta, Cap. II f. 144.

⁴⁹ Statuta, Cap. II-IV, f. 144-146.

⁵⁰ Për detyrat e rektorit shih: Statuta, Cap. IV, f. 145-146.

⁵¹ Statuta, Cap. II-III, f. 144-145.

⁵² AAlb. II, nr. 98.

⁵³ Për detyrat e prokuratorit shih: Statuta, Cap. V, f. 146.

vreshtave të pronave të kanonikës dhe këtë ai e bënte me urdhër të rektorit.

Ai kërkonte të ardhurat dhe i depozitonte në kanonikë. Ai ishte përgjegjës për shpenzimet dhe ishte i detyruar të kursente sipas rregullave të kanonikës. Edhe paratë ose objekte të tjera që i jepeshin kanonikës me testament nga persona të tjerë të jashtëm merreshin në dorëzim të dokumentuara me noter ose gjykatës nga prokuratori. Si shembull mund të përmend këtu një testament të presbiterit drishtjan Martin, që me anë të cilit i lë amanet 60 hyperperë Kapitullit të Shën Mërisë së Drishtit me ndërmjetësinë e dy personave të tjerë të quajtur Pashka arpunues (*Pasca aurifice*) dhe de Sorko. Testamenti i mëposhtëm që përpiluar në Raguzë dhe si dëshmitarë kishin qenë te gjykatësi Marinus Lukari dhe Marinus Helie de Sorko.⁵⁴

Prokuratori ishte “syri dhe veshi” i rektorit dhe ishte ndihmësi i tij kryesor. Kanonikët nuk ishin të detyruar t’i binden në raste shkeljesh nga ana e tij. Ai gjithashtu nuk kishte tagër të dënonte askënd në raste fajesh dhe dëmsh dhe për këtë duhet të lajmërohej rektori. Megjithatë, ashtu si rektori edhe prokuratori kishte si detyrë të merrte pjesë në të gjitha gjyqet qoftë kishtarë qoftë shekullare në qytetin e Drishtit.

Diskutimet që bëheshin brenda kapitullit konsideroheshin si sekrete që nuk duhet të dilnin përjashta dhe në rastet kur kjo gjë ndodhte, kanoniku përgjegjës përjashtoj zakonisht për një vit nga kapitulli, dhe në rastet kur sekreti i nxjerrë përjashta ishte tepër i rëndësishëm, atëherë kleriku fajtor mund të dënohej edhe me lëçitje dhe i hiqeshin të gjitha shpresat se mund të falej.⁵⁵ Dënimi me një vit përjashtim nga kapitulli zbatohet edhe në ato raste kur kleriku bënte betim për dëshmi të rreme. Kanonikët ishin të detyruar që të merrnin pjesë në diskutimet brenda kapitullit, sepse duhet të votonin dhe të thonin mendimin e tyre, për këtë punë thirreshin personalisht, dhe nëse ata nuk paraqiteshin, dënoheshin nga kapitulli sipas rëndësisë së çështjes, me përjashtim të atyre rasteve, kur mosparaqitja ishte e justifikuar dhe e arsyeshme.⁵⁶

⁵⁴ AAlb. II, nr. 99.

⁵⁵ Statuta, Cap. XVIII, f. 153.

⁵⁶ Statuta, Cap. XIX, f. 153-154.

Lutjet, procesionet dhe javët e shërbimit

Kanonikët ishin të detyruar të mbajnë javët shërbyese të tyre në kishë me përpikëri dhe kjo mbajtja e javës kishte të bënte me një pjesëmarrje të rregullt në meshët gjatë ditës, të cilat përbëheshin nga mesha e mëngjesit, e mbrëmjes, e natës dhe orët hyjnore.⁵⁷ Kundërvajtësi dënohej me dy grosh për çdo meshë, në mëngjes dhe në mbrëmje. Në ditët e diela dhe në ditët e festave meshët këndoheshin nga dy herë, kurse ditën e hënë kishte një meshë të veçantë për të vdekurit, e cila shoqërohej me një procesion nëpër varreza. Vëmendja kryesore e meshës u kushtohej atyre personave të ndjerë, që gjatë jetës së tyre i kishin lënë kishës pasuri e prona, bile edhe lëmosha.⁵⁸

Mosmarrja pjesë në këto mesha dënohej me një grosh dhe kanonikut fajtor nuk i jepej as vera e as pjesa e lëmoshës që është mbledhur atë ditë. Nuk po ndalem më tej në lidhje me praktikimin e meshave nga kanonikët, sepse janë të shumta dhe të llojeve të ndryshme. Një rëndësi të veçantë nëpër meshë i vihej edhe përkujtimit të emrave të atyre personave që kishin qenë bamirës ndaj kanonikës. Prandaj në statute urdhërohet që “çdo të diel të shpalleshin në mensë të gjithë ata bamirës të shtëpisë sonë që kanë vdekur atë javë ... dhe të hënë pasuese në meshën për të vdekurit javori t’i lutet Zotit për shpirtrat e tyre; të përkujtohet në të gjitha meshat gjatë gjithë javës që bëhen lutjet për të vdekurit.”⁵⁹

Arkivi dhe dokumentet

Çdo gjë që shqyrtohej, privilegjet dhe dokumentet e ndryshme ruheshin në arkivin e Kapitullit, duke i futur në shakuj* apo thasë dhe në arka të zakonshme dhe duke i vulosur me tri unaza (*obsignata in saculis cum tribus anulibus, et in capsula solita*).⁶⁰ Pra, këtu lë të kuptohet që Kapitulli kishte një arkiv të tijin të mirëfilltë me vulën e tij sekrete që ruhej mirë dhe me një praktikë të rregullt ruajtjeje, sepse dokumentet ruheshin me aq seriozitet sa që nuk lejohej që të shënohej as edhe një shkronjë e vetme sipër tyre dhe nuk lejohej të merrej as edhe një privilegj a ndonjë dokument tjetër nga arkivi, pa pasur lejen e Kapitullit që

⁵⁷ Statuta, Cap. VII-VIII, f. 147-148.

⁵⁸ Statuta, Cap. VIII, f. 149.

⁵⁹ Statuta, Cap. LIII f. 175.

* në origjinalin lat. *in saculis* = në shakuj, në thasë

⁶⁰ Statuta, Cap. XX, f. 154.

mblidhej posaçërisht për atë punë. Kundërvajtësi deklarohej si vjedhës dhe falsifikator i ulët dhe i privohej aksesit në arkiv.⁶¹

Hajnia dhe mashtrimet

Në lidhje me vjedhjet dhe mashtrimet kishte dënime të ndryshme të cilat në statute nuk përcaktohen qartë. Kundërvajtësi për dëme jo të mëdha, dëbohej për një vit dhe gjoha që duhej të paguante ishte sa dyfishi i vlerës së vjedhur dhe duhej të paguhej me këste, kurse në rastet e dëmeve më të mëdha, atëherë dënimet ishin më të mëdha.⁶²

Udhëtimet në dobi të kanonikës

Kanonikët ishin të detyruar bënin udhëtime të ndryshme në dobi të kapitullit dhe këto udhëtime ishin qoftë brenda dioqezës qoftë jashtë saj dhe më larg. Udhëtimet i caktonte prokuratori. Kanonikut i jepeshin nga kanonika shpenzimet dhe gjatë kohës që mungonte i jepej çdo hise që ndahej në kanonikë. Bënin këtu përjashtim vetëm ato udhëtime që bëheshin për në vreshtat e kanonikës.⁶³ Për këto lloj udhëtimesh, u jepeshin kanonikëve vetëm ajo që u takonte zakonisht, pa iu hequr shpenzimet e rrugës.

Udhëtimi për te vreshtat është një indikacion që pasuritë e patundshme të Kanonikës, si p. sh. vreshta, ullishta, etj., mund të ishin edhe jashtë truallit të dioqezës. Nëse udhëtimi brenda dioqezës që zgjaste 1 ditë refuzohej, atëherë kanoniku përgjegjës përjashtohej për shtatë ditë me një gjobë që jepej në sasi vere ose, në rast se nuk kishte verë në shtëpi, atij i duhej të paguante një shumë prej katër groshësh. Në rast se udhëtimi duhej të bëhej jashtë dioqezës dhe kanoniku nuk bindej, atëherë ai dënohej deri me një gjysmë viti përjashtim.⁶⁴ Gjithashtu edhe ata kanonikë që mungonin për tetë ditë nuk merrnin asgjë nga pjesa (verë dhe ushqime) që u takonte, deri sa ata të ktheheshin. Përjashtoheshin këtu rastet, kur kanoniku kishte ikur për ndonjë shërbim i ngarkuar nga vetë kanonika.⁶⁵

⁶¹ Po aty.

⁶² Statuta, Cap. XXIII, f. 155.

⁶³ Statuta, Cap. XXIV, f. 156.

⁶⁴ Statuta, Cap. XXII, f. 155.

⁶⁵ Statuta, Cap. XXIX, f. 162.

Dënime për shkelje të mirësjelljes dhe të moralit

Sipas fjalëve të Jezus Krishtit “*Paqen time po ju jap juve, paqen po u lë juve*” (*Pacem meam do vobis, pacem relinquo vobis*)⁶⁶, kanonikët duhej të jetonin në paqe dhe të kishin respekt për njeri-tjetrin, nuk duhej të bërtisnin, kur ndodheshin brenda ambienteve të kanonikës, dhe në rast se plasnin grindjet dhe sharjet, atëherë rektori ose prokuratori, ose në mungesë të tyre edhe ndonjë nga pleqtë, i urdhëronte që të ndërprisnin grindjet. Nëse ata nuk bindeshin, atëherë merrnin urdhrin për të dalë jashtë dhe nëse nuk dilnin jashtë, pasi u është urdhëruar atyre për të tretën herë, atëherë ata dëboheshin për një vit, plus ndonjë dënim shtesë që mund t’u ishte dhënë.⁶⁷ Pra, dënimi ishte mjaft i rreptë dhe mund të mjaftonin vetëm disa sekonda mosbindjeje për t’u dënuar me një vit përjashtim.

Kanonikët nuk lejoheshin që t’i binin tryezës me grusht, në zemërim e sipër, dhe në rast se diçka e tillë ndodhte atëherë fajtori dëbohej për aq javë sa i kishte rënë tryezës.⁶⁸ Ofendimet e ndryshme kishin edhe dënime të ndryshme. Për shembull rrahja midis bashkëkanonikësh dënohej shumë rëndë dhe grada e dënimit fillonte nga shkishërimi deri në një vit dëbim, sipas shkallës së dhunës që kishte ushtruar fajtori.⁶⁹ Bëheshin përjashtime vetëm atëherë kur kanoniku “e bën pa dashje për vetëmbrojtje, sepse, natyrisht, lejohet që dhuna të kundërshtohet me dhunë, kur nga shkak i grindjes secili mbron veten me maturi, por mjafton që të mos jetë fajtor.”⁷⁰ Dënimi bëhej, pasi çështja ishte shtruar në kapitull dhe jepej që të nesërmen, nëse nuk ishte ditë feste.

Kanonikët, në rast se kishin ankesa kundër ndonjë bashkëkanoniku ose edhe ankesa në lidhje me gjykimin e bërë nga rektori apo nga kapitulli ndaj tij, ishin të detyruar t’i parashtronin ato vetë brenda kapitullit, i cili i jepte atij të drejtën e fjalës në një mbledhje posaçërisht për të. Por në qoftë se ata i çonin ankesat gjetiu atëherë rrezikonin përjashtimin e përgjithmonshëm nga kanonikati, ose deri në gjashtë muaj dëbim.⁷¹

⁶⁶ Shiko Ungjilli sipas Gjonit 14, 27.

⁶⁷ Statuta, Cap. XXVI-XXVII, f. 156-157.

⁶⁸ Statuta, Cap. XXVIII, f. 157.

⁶⁹ Statuta, Cap. XXIX, f. 158.

⁷⁰ “*Hoc autem intellegimus si verberans sponte verberasset et non onvitus se deffendendo. Tunc enim licet vim vi epelere cum moderamine inculpate tutele, dum tamen non fuerit talis, deffendens, causam rixe.*” Statuta, Cap. XXIX, f. 158.

⁷¹ Statuta, Cap. XXX, XXXI, XXXIII, f. 159-160.

Akt i dënueshëm ishte sigurisht dhe *konkubinati* dhe kanonikut që kishte marrë një konkubinë i kërkohet që të merrte një vendim, ose të mbante konkubinën e të largohej nga kanonika përgjithmonë e të mos kishte më pjesë aty, ose ta lërë konkubinën e të falej me qëllim që të vazhdonte të ishte kanonik, dhe për këtë i jepej afat deri në tre muaj. Në rast se ai brenda kësaj kohe nuk ndreqej atëherë nuk konsiderohej më kanonik, përjashtohej përgjithmonë nga kapitulli dhe askush nuk kishte të drejtë t'i ndihmonte që të kthehej.⁷² Për të shmangur edhe ndonjë sjellje tjetër që kishte të bënte me shkeljen e moralit përsa i përket qëndrimit ndaj grave, në kanonikë nuk lejohej që të silleshin vajza, edhe nëse ato ishin të lidhura familjarisht me ndonjërin nga kanonikët, p.sh. mbesa apo kushërira.⁷³ Në statute nuk cilësohet, nëse lejohet, apo nuk lejohet të vijnë nënat apo motrat e kanonikëve.

I dënueshëm ishte edhe çdo lloj loje kumari, si për shembull loja me zaret (*ludere ad taxillos*), apo lojëra të tjera me të holla. Në rastet kur ndonjë kanonik zbulohet, atëherë përjashtohej për shtatë ditë nga kapitulli.⁷⁴

Cilët ishin kanonikë të Drishtit?

Në vazhdim po paraqes një listë të kanonikëve të Drishtit të identifikuar deri më tani. Kjo listë në fakt nuk pretendon që të jetë e plotë, ngaqë diçka e tillë nuk është e mundur, pasi kanonikët e Drishtit në rrjedhën e shekujve mund të kenë qenë me mijëra dhe nuk disponojmë ende regjistra, por ajo synon që duke dhënë disa emra, ta bëjë sa më të plotë dhe sa më të kuptueshme çështjen në shqyrtim. Emrat jepen sipas kriterit alfabetik, duke shënuar në kllapa edhe vitin, në të cilin është i dokumentuar kanoniku:

Kanonikë të Drishtit para pushtimit osman:

Andre Prekali (<i>Andreas Precalus</i>)	1461 ⁷⁵
Andre Zaon (<i>Andreas Zaon</i>)	1461 ⁷⁶
Anto Kazeli (<i>Anto Casel</i>)	1461 ⁷⁷
Dominik Grinçari (<i>Domenicus Grinçarius</i>)	1368 ⁷⁸

⁷² Statuta, Cap. XXXV, f. 161-162.

⁷³ Statuta, Cap. XXXVIII, f. 162.

⁷⁴ Statuta, Cap. XXXVII, f. 162.

⁷⁵ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

⁷⁶ *Po aty.*

⁷⁷ *Po aty.*

⁷⁸ *Statutet dhe urdhëresat*, f. 46.

Dominik Prekali (<i>Dominicus Precalli</i>)	1461 ⁷⁹
Frank Merti (<i>Francus Mertus</i>)	1461 ⁸⁰
Gjegj Golemi (<i>Georgius Golemo</i>)	1461 ⁸¹
Gjergj Jonima (<i>Georgius Gionima</i>)	1461 ⁸²
Gjoni, Imperatori (<i>Johannes imperator</i>)	1461 ⁸³
Martin Mazioti (<i>Martinus Masiotus</i>)	1461 ⁸⁴
Nikollë Beli (<i>Nicolaus Bellus</i>)	1450 ⁸⁵
Nikollë Cesani (<i>Nicolaus Cesan</i>)	1461 ⁸⁶
Nikolla Drishtit (<i>Nicolaus de Drivasto</i>)	
që ishte edhe prokurator i kapitullit	1353 ⁸⁷
Nikollë Kalançi (<i>Nicolaus Calantius</i>)	1461 ⁸⁸
Nikollë Pisharagu (<i>Nicolaus Pisciaragus</i>)	1461 ⁸⁹
Nikollë Suma (<i>Nicolaus Summa</i>)	1449 ⁹⁰
Nikollë Ungri (<i>Nicolaus Hungarus</i>)	1450 ⁹¹ , 1508-1514. ⁹²
Novak Prekali (<i>Novachus Precalli</i>)	1461 ⁹³
(më herët <i>Nikolaus IV, Episcopus Drivastensis</i>)	1457 ⁹⁴

Pal Engjëlli i quajtur Merivizi, kryediakon

(*Paulus Angelus dicto Mervisio archidiachonus*) 1461⁹⁵, që nuk duhet të ngatërrohet me të mëposhtmin, pasi ishte më i vjetër në moshë.

Pal Engjëlli (*Paulus Angelus, archiepiscopus Dyrrachiensi*) arqipeshkvi i mëvonshëm i Durrësit duhet të ketë qenë po ashtu kanonik i këtij kapitulli, pasi fillimet e para si klerik (presbiter) Pali i pati në Drisht, dhe

⁷⁹ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

⁸⁰ *Po aty*.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *Po aty*.

⁸³ *Po aty*.

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ AAlb. II, nr. 98, 99.

⁸⁸ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ AAV XX, nr. 5444.

⁹¹ *Po aty*, nr. 5594.

⁹² Lucia Nadin-Bassani, *Migrazione e intergrazione: il caso degli Albanesi a Venezia (1479-1552)*. Roma: Bulzoni 2008, f. 93.

⁹³ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

⁹⁴ D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 243.

⁹⁵ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

përveç kësaj ai duhet të ketë qenë edhe personi që u mor me fiksimin e Statuteve të kapitullit⁹⁶, porse mbi vitet e pranisë së tij në kapitull nuk kemi të dhëna.

Pal Kelanti (<i>Paulus Chelantius</i>)	1461 ⁹⁷
Pjetër Martusi, arqidiakon (<i>Petrus Martusi</i>)	1445 ⁹⁸
Pjetër Sakati (<i>Petrus Saccato</i>)	1461 ⁹⁹
Pjetër Skepudari (<i>Petrus Schepudar</i>)	1368 ¹⁰⁰
Pjetër Suma (<i>Petrus Summa</i>)	1450 ¹⁰¹
Pjetër Shpani, (<i>Petrus Span</i>)	1402 – 1423 ¹⁰²

Kanonikë pas pushtimit osman të Drishtit, të cilët jetonin në Itali:

Ungarus, i biri i një Nikollë Ungri, vojvodë i Drishtit	1478, ¹⁰³
Aleks Duda (<i>Alessio Duda Drivastense</i>)	1515, ¹⁰⁴
Andrea Engjëlli (<i>Andrea Angelus</i>)	†1581, ¹⁰⁵
Dhimitër Frangu (<i>Demetrio Franco</i>)	1515, ¹⁰⁶
Luka Spiron	1529, ¹⁰⁷
Pal Engjëlli (<i>Paulus Angelus</i>) pas vitit	1500, ¹⁰⁸
Mark Elia, kanonik i Drishtit	1517, ¹⁰⁹

⁹⁶ O. Schmitt, "Paul Angelus", në: *ΘΗΣΑΥΡΙΑΜΑΤΑ* 30 (2000), f. 148.

⁹⁷ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

⁹⁸ AAV XIX, nr. 5156.

⁹⁹ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

¹⁰⁰ AAlb. I, nr. 252, shih edhe: Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, f. 27.

¹⁰¹ *Statuta et Ordinationes*, f. 143.

¹⁰² *Statutet dhe urdhëresat*, f. 47.

¹⁰³ Dokumenta (1479-1506). Pj. II, nr. 33.

¹⁰⁴ Dokumente të Shek. XVI-XVII. Vëll. I, nr. 164.

¹⁰⁵ *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata. Prior Familias ac Stemmata imperatorum Constantinopolitarum, cum corundem Augustorum Nomismatibus, & aliquod Iconibus; Præterea Familias Dalmaticas & Turcicas complectitur: Alter Descriptionem Urbis Constantinopolitanæ qualis extitit sub Imperatoribus Christianis. Auctore Carolo Du Fresne Domino Du Cange, Regi a Consiliis, Francæ pud ambianis Questore. Venetiis, Ex Typographiæ Bartolomæi Javarina M. DCC. XXIX, f. 173. (Cituar si: C. Du Cange, *Historia Byzantina*, f.)*

¹⁰⁶ Dokumente të shek. XVI-XVII, Vëll. I, nr. 164.

¹⁰⁷ L. Nadin-Bassani, *Migrazione e integrazione*, f. 127.

¹⁰⁸ Du Cange, *Historia Byzantina*, f. 173.

¹⁰⁹ Mark Elia, kanonik i Drishtit përmendet në dokumentet noteriale të Antonio Spitit. Lucia Nadin, *Shqiptarët në Venedik. Mërgim dhe integrim (1479-1552)*, përkthyer nga Pëllumb Xhufi. Tiranë: "Shtëpia Botuese 55" 2008, f. 158.

Përfundime

Këto pra ishin disa të dhëna thelbësore, me anë të së cilave u bënë përpjekje të pasqyrohen shkurt, qoftë përmbajtja e *Statuteve të Kapitullit të Katedrales së Drishtit*, qoftë identiteti i kanonikëve të këtij kapitulli, duke dhënë aspekte të ndryshme nga jeta dhe aktiviteti i tyre sipas statuteve, si dhe duke përmendur emra konkret të këtyre kanonikëve.

Pra, siç e pamë edhe në kapitullin e mësipërm dioqezës së Drishtit nuk i mungonin as monumente kishtare, as manastire, po ashtu edhe urdhrat qenë mjaft të pranishëm në atë qytet, sidomos Urdhri Benediktin që kishte edhe manastirin e Rashit dhe më vonë edhe urdhri françeskan që me kalimin e kohës u zuri vendin benediktinëve.

Kishat e Drishtit ishin të shumta¹¹⁰ por jemi të mendimit që, nëse bëhen gjurmime të mjaftueshme mund të dalin në pah edhe kisha të tjera, sidomos disa nga ato kisha që në tekst përmenden si qela, të cilat mesa duket gjendeshin të përhapura gjithkund nëpër qytet. Ekzistenca e dy katedraleve (të Shën Mërisë dhe të Shën Gjergjit të cilat kishin edhe kapituj) dhe e manastirit që ndodhej disa kilometra larg nga Drishti tregonin mbi rëndësinë që ka pasur në atë kohë Ipeshkvia e Drishtit, që konsiderohej edhe si fidanishte e klerit katolik ndër trojet shqiptare.

S u m m a r y

THE CANONICALS OF THE CATHEDRAL OF DRIVASTO SECOND THEIR STATUTES

In the article I have tried to bring e view of the life and the organization of the canonicals of the Cathedral in the medieval city of Drivasto (Northern Albania). The clerical society of Drivasto was organized in two main groups, who were the canonicals of the Cathedral of St. Mary and the canonicals of the St. Georg's Church. The canonicals of the St Mary's Cathedral had their own statutes, which is like a constitution for such institution. In these statutes we see the different rules, that organized the life, function and the work between the

¹¹⁰ Në lidhje me Kishat e Drishtit shih: Edmond Malaj, "Monumente kishtare të Drishtit në Mesjetë", në: *Studime historike*, Nr. 1-2, 2014, Viti LXVIII (LI), f. 33-52.

members of these clerical society. There are here specific articles on choosing the rector, the canonics, and so on. In the end, there is e list with names of the canonicals of Drivasto, which gives as much information's about their social descendance.